



**NGACMIMI  
DHE BULIZMI  
ME BAZË  
HOMOFOBINË  
DHE  
TRANSFOBINË**



Ky publikim mbështetet nga BE



*“Gjatë shkollës kam vuajtur shumë nga bulizmi. Ofendimet kanë qenë nga më të ndryshmet, sepse rrija më shumë me vajzat dhe në shtëpi kisha dy motra. Një herë, në klasë të katërt, teksa shkoja në tualet, disa djem më thanë: “Tualeti i vajzave është andej”! Gjatë pushimit rrija vetëm me vajzat. Kur vura një vath në vesh shokët e klasës më rrahën. Sharjet të tipit pederast, femër, shko në shtëpi, ishin të shpeshta. Vetëm në gjimnaz, fillova të pranoj veten dhe të ndihem më mirë me orientimin tim.” D.M, 19 vjeç, Tiranë.*

Ngacmimi është një përvojë shqetësuese dhe e frikshme në çdo fazë të jetës, por për të rinjtë përvoja e ngacmimit homofobik dhe transfobik, sidomos në një fazë të pambrojtur në jetën e tyre, mund të jetë katastrofike, duke çuar në izolim, frikë dhe vetë-fajësim.

Për shumë të rinj, vitet e adoleshencës janë një kohë e rritjes dhe përvojave të reja, me fillimin e pubertetit, ndryshimin e shkollave dhe rritjen e pavarësisë. Për shumë, rritja e vetëdijes mbi seksualitetin dhe e vetëdijes mbi orientimin seksual mund të jetë pjesë e përvojës normale të rritjes.

Pavarësisht nëse një i ri është heteroseksual, gej, lesbike, biseksuale apo transgjinnor, orientimi i tij/saj seksual dhe identiteti gjinnor, tashmë është formuar dhe miqësitë e shkalla e pranimit të bashkëmohatarët janë parësore.

“Ky material është publikuar me mbështetjen e Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij publikimi janë përgjegjësi e Ambasadës PINK / LGBT Pro dhe partnerëve të saj dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian”.

**Homofobia dhe transfobia është ngacmimi ose trajtimi i dëmshëm i personave LGBT dhe personave të perceptuar si të tillë. Ajo mund të ndodhë në çdo mjedis, përfshirë edhe në mjediset e shkollës.**

Homofobia dhe transfobia përfshin një gamë të ndjenjave dhe sjelljeve, qëndrime të cilat janë bërë shpesh të qarta për të rinjtë, nga sikleti dhe frika, deri tek neveria, urrejtja apo dhuna. Ajo mund të shfaqet në mënyra të ndryshme, nga homofobia personale e përbërë nga bindjet dhe paragjykimet personale të një personi deri tek homofobia institucionale dhe kulturore e cila i referohet vlerave shoqërore dhe “normave”, ku heteroseksualizmi privilegohet mbi të gjitha format e tjera të shprehjes gjinore dhe orientimit seksual.

Studentët gej dhe lezbike shpesh ndihen të padukshëm në shkollat e tyre. Padukshmëria e tyre përforcohet në mënyrë tipike nga pranimi i përgjithshëm i sjelljeve heteroseksuale në mjedisin e tyre, e cila i bën që të rinjtë gej dhe lezbike të ndjehen të padukshëm, pa mbështetje dhe të izoluar.

Pa mbështetjen e duhur, një i ri/e re mund të përballet me një breshëri të përditshme të komenteve homofobike, të cilat mund të çojnë në braktisjen e shkollës, izolim, dhunë, përdorim të alkoolit dhe të drogës. Për fat të keq për disa, përvojat e hershme mund të çojnë në pasoja shumë afatgjata të tilla si depresioni, vetëvrasja dhe jeta në rrugë.

## Sa shpesh ndodh ngacmimi dhe bulizmi mbi bazë homofobinë dhe transfobinë?

Ndonëse në Shqipëri ka patur progres të ndjeshëm gjatë viteve të fundit në raport me rritjen e sensibilizimit mbi të drejtat e komunitetit LGBT, realiteti kulturor, traditat patriarkale dhe paragjykimet, bëjnë që shumë të rinj LGBT ose të perceptuar si të tillë të bëhen viktimat të bulizmit të vazhdueshëm nga bashkëmoshatarët e tyre, mësuesit apo edhe të afërmit.

*“Që në shkollën fillore kam vuajtur bulizmin, sidomos nga vajzat. Çdo ditë shkoja në shkollë me frikën se vajzat do më ngacmonin, do më thërrisnin me fjalë ofenduese. Më shumë kam vuajtur nga mësuesja e anglishtes, e cila më fliste me ironi, përçmim, kunja sa herë hyja në klasë. Një ditë, një grup prej rreth 15 vajzash, më rrahën duke më poshtëruar me fjalë të ndryshme në oborrin e shkollës”. M. 20 vjeç, Vlorë.*

---

Ndërkohë, një studim i realizuar në periudhën Shtator-Nëntor 2011 nga Fondacioni gjerman “Friedrich Ebert” me fokus rininë shqiptare, tregon se 50% e të rinjve, nga të cilët 67% meshkuj dhe 46% femra, nuk do të pranonin fqinjësi me një çift homoseksual, duke treguar një nivel të lartë paragjykimi dhe mospranimi ndaj këtij komuniteti. Të rinjtë në fshatra janë më paragjykes se sa të rinjtë në qytet, ndërsa femrat rezultojnë të jenë më tolerante ose indiferente nga fqinjësia me një çift homoseksualësh.

## Shenjat e sjelljeve homofobike dhe transfobike përfshijnë:

- Dhuna verbale ose fizike, duke përfshirë dhunën seksuale;
- Komentet nënçmuese, sharjet, fyerjet, shakatë apo kërcënime rreth orientimit seksual ose praktikës seksuale;
- Detyrimi i njerëzve për të zbuluar ose fshehur orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor;
- Kur lidhet orientimi seksual dhe identiteti gjinor me pedofilinë (abuzimin seksual të fëmijës);
- Kur akuzohen persona LGBT për “rekrutimin” e personave të tjerë për t’u bashkuar me orientimin e tyre seksual;
- Njoftime, postera, mesazhe ose grafite homofobike dhe transfobike;
- Refuzimi nga miqtë apo anëtarët e familjes për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor;
- Sjellja kur orientimi seksual paraqitet se është vetëm një lidhje seksuale ose një “zgjedhje e mënyrës së të jetuarit”;
- Trajtimi i orientimit seksual apo identitetit gjinor të personave LGBT si më pak të vlefshme sesa ato të heteroseksualëve;
- Sjellja sikur të gjithë personat LGBT kanë HIV/AIDS ose janë përgjegjës për përhapjen e saj.

## **Këshilla se si të veprojmë në rast bulizmi**

Ashtu si për shumë vështirësi, edhe në këtë rast, nuk ka përgjigje magjike! Për shumë të rinj, të cilët së pari bëhen të vetëdijshëm se ata janë LGBT, mund të duan të flasin me dikë që i dëgjon dhe i pranon ashtu siç janë. Nëse i riu/e reja është në fazën e hershme të marrëdhënies me seksualitetin e tij/saj, ose dëshiron të rrëfejë përvojën e tij e të qenurit gej apo lezbike, ajo që ai/ajo do më së shumti, është që dikush ta dëgjojë dhe ta pranojë ashtu siç është.

Për të rinjtë, të cilët përjetojnë bulizëm dhe/ose ngacmim mbi baza homofobike dhe transfobike, është e rëndësishme që të tjerët, sidomos prindërit dhe kujdestarët, të jenë atje për të dëgjuar, për të besuar dhe për të ndihmuar personin që të kuptojë se bulizmi dhe ngacmimi nuk ndodh për faj të tyre. Është e rëndësishme t'i lihet kohë të riut për të shqyrtuar gjendjen, mundësitë dhe ndjenjat e tij për atë që po ndodh.

Të rinjtë duhet të jenë pjesë e planit për të ndaluar bulizimin dhe ngacmimin, duke iu dhënë atyre kohë për të shqyrtuar se si ata do të donin të ndryshonin dhe bëheshin gjërat. Kjo mund t'i ndihmojë ata për t'i menduar gjërat më qartë.

Efektet e bulizmit dhe ngacmimit homofobik dhe transfobik mund të jenë shkatërruese dhe shumica e të rinjve do të kërkojnë mbështetjen e prindërve dhe mësuesve. Efektet të tilla si: stresi, ulja e aftësisë për t'u përqëndruar, përkeqësimi i rezultateve të shkollës, ankthi, humbja e besimit dhe mungesa e vetë-respektit, nuk mund të injorohen.

Ka një sërë shenjash që mund të paralajmërojnë dikë për faktin se një i ri është duke u keqtrajtuar. Një humbje e oreksit apo e regjimit të të ngrënit të zakonshëm, abuzimi me alkoolin ose substancat, sjelljet agresive, depresioni, sulmet e panikut apo përpjekje për vetëvrasje, të gjitha këto mund të jenë shenja që nuk mund dhe nuk duhet të injorohen. Është e rëndësishme të kujtoni që këto shenja mund të tregojnë vështirësitë e tjera që nuk janë të lidhura me bulizimin, kështu që vetëm duke folur me personin, ju do të merrni një pasqyrë të plotë të asaj që po ndodh.



## Kujt mund ti drejtohemi për mbështetje?

Një i ri/e re viktimë e bulizmit dhe ngacmimit mund të ketë nevojë për mbështetje profesionale apo këshillim, për të shprehur ndjenjat negative dhe për të rindërtuar vetë-besimin. Prindërit dhe mësuesit shpesh kanë pyetje se ku mund të marrin mbështetje në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me bulizmin dhe ngacmimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

### Shërbime në dispozicion përfshijnë:

- **Ambasada PINK/LGBT Pro Shqipëri**, organizatë e cila punon për të drejtat e komunitetit LGBT në vend.  
[www.pinkembassy.al](http://www.pinkembassy.al)  
Email: [info@pinkembassy.al](mailto:info@pinkembassy.al);  
Facebook:  
[www.facebook.com/groups/pinkembassy](https://www.facebook.com/groups/pinkembassy)
- Shërbimi **ALO 116 111** në dispozicionin tuaj 24 orë në ditë. Telefoni falas në çdo kohë numrin **116 111**, nga celulari juaj ose numri fiks. Psikologë dhe punonjës socialë do të jenë aty për t'ju ndihmuar në çdo moment; Lexo [www.alo116.al](http://www.alo116.al) për këshilla praktike për të rinjtë dhe bulizmin.
- **Streha LGBT**  
Tel: +355 699839189  
Email: [sos@strehalgbt.al](mailto:sos@strehalgbt.al); [info@strehalgbt.al](mailto:info@strehalgbt.al);  
[ndihme@strehalgbt.al](mailto:ndihme@strehalgbt.al)